VENDIM
Nr. 690, datë 5.10.2016

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË NDRYSHIMIT NR. 1 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF018931, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA QEVERIA E KONFEDERATËS ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA SEKRETARIATI SHTETËROR ZVICERAN PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE (SECO), NË KUADËR TË FONDIT TË MIRËBESIMIT TË SECO-s, PËR FUQIZIMIN E KAPACITETEVE MBIKËQYRËSE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit ndryshues nr. 1 të marrëveshjes së grantit nr. TF018931, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), në kuadër të fondit të mirëbesimit të SECO-s, për fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BANKA BOTËRORE
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA E ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR

1818 H Street N.W.
Washington D.C.20433
USA

(202) 477-1234
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVAS

2 mars 2016

Shkëlqesisë së Tij, Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Lënda: **AMF në Shqipëri – Fondi i Mirëbesimit SECO për Forcimin e Kapaciteteve Mbikëqyrëse, Granti SECO nr. TF018931**
Ndryshimi nr. 1 në Marrëveshjen e Grantit

Shkëlqesi!

Po i referohemi marrëveshjes së Grantit, të datës 10 korrik 2015 (Marrëveshja), ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) për grantin e lartpërmendur (Granti).

Në vijim të diskutimit të fundit ndërmjet Bankës Botërore dhe Përfituesit, Banka Botërore ka rënë dakord që të bëjë ndryshime në marrëveshje për të shtyrë datën e mbylljes si më poshtë:

Paragrafi 3.03 i aneksit të marrëveshjes ndryshohet dhe zëvendësohet në tërësinë e tij si më poshtë:

"3.03. Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes në seksionin 3.06/c të Kushteve Standarde është 31 mars 2019.

Të gjitha kushtet dhe afatet e marrëveshjes, me përjashtim të atyre të ndryshuara në këtë dokument, mbeten në fuqi të plotë.

Ju lutem, konfirmoni miratimin nga ana juaj për ndryshimin e lartpërmendur, duke nënshkruar dhe shënuar datën në këtë dokument në hapësirën e dhënë më poshtë. Ky dokument ndryshimi do të bëhet në dy kopje, secili prej tyre do të jetë origjinal dhe njëri prej tyre do të na dërgohet neve. Dispozitat e parashtruara në këtë dokument ndryshimi do të hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të Bankës Botërore nga Përfituesi për përmbushjen e procedurave të brendshme.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA E ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR

Nga (emri) (mbiemri)
_____
Tahseen Sayed
Menaxhere për vendin
Zyra e Bankës Botërore në Shqipëri

Miratuar:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË:

Nga: _____
Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____
Titulli: _____
Data: _____